

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

ABSTRAKT

Programi i studimit : Fakulteti Juridik "PROGRAMI JURIDIKO -FINANCIAR"

Kandidatja : BUBULINA CAKOLLI

Mentor : BEDRI PECI

Tema : “Tregtia e Jashtme e Kosovës-Barrierat Tregtare dhe Doganore”

Në këtë punim diplome flitet mbi rrjedhat e tregtisë së Kosovës barrierat dhe kufizimet e tjera me të cilat ballafaqohet sektori i eksportit dhe importit.

Kosova është pjesë e CEFTA-së, Marrëveshjes për Tregti të Lirë që nga viti 2006 ku prapë do të diskutohet për vështirësitë me të cilat po ballafaqohet vendi ynë.

Tema elaborohet edhe për Doganat kuptimin, rëndësinë dhe ndarjen e tyre, e rëndësishme si dhe marrëveshjet tregtare mes Kosovës dhe shteteve fqinje, pengesat e identifikuarat si dhe zbatimi i tyre.

Këtu ju është referuar ligjeve: Ligjit Doganor dhe i Akcizave në Kosovë si dhe Ligjit për Investimet e Huaja, e rëndësishme është interpretimi i këtyre ligjeve, zbatimi i tyre për lehtësimin e procesit në barrierat tregtare. Gjatë punimit të temës me titull “Tregtia e Jashtme e Kosovës-Barrierat Tregtare dhe Doganore” është përgatitur intervistë me Depon e Barnave në Kosovë “Santefarm” Sh.p.k ku kjo lloj interviste do ta plotësoj temën dhe do ta bëjë më interesante sepse janë hartuar pyetje të ndryshme lidhur me temën e lartë cekur dhe janë marë përgjigjet e duhura.

Punimi i temës master me titull “Tregtia e jashtme e Kosovës – Barrierat Tregtare dhe Doganore” të kandidatës Bubulina Cakolli është hartuar në 57 faqe. Punimi ndahet në 5 kapituj kryesor:

Në Kapitullin e I të quajtur Politika Tregtare në Republikën e Kosovës kandidatja ka përfshirë këta nënkapituj: 1. Politika Tregtare 2. Tregtia e Jashtme e Kosovës 3 Veçoritë e tregtisë ndërkombëtare të Kosovës 4. Identifikimi i Barrierave në Tregtinë e Jashtme 5. Tregjet Potenciale për Prodhimet e Kosovës 6. Regjimi Tregtar dhe Lidhjet Institucionale 7. Liberalizimi i Tregtisë 8. Anëtarësimi në OBT 8. Drejtimet e Politikës Tregtare të Kosovës

Në Kapitullin e II të quajtur Kosova në CEFTA, Doganat dhe Roli i Tyre kandidatja ka përfshirë këta nënkapituj: 1. Kosova në CEFTA 2. Ndikimi i CEFTA-së në Ekonominë Kosovare 3. Doganat Kuptimi dhe Rëndësia e tyre, ndarja e Doganave dhe Terminologjia Doganore

Në Kapitullin e III të quajtur Tregjet Kërkojnë Liri kandidatja ka përfshirë këta nënkapituj: Liria kërkon Tregje 2. Politika dhe Tregtia e Jashtme 3. Bashkëpunimi kundrejt Konfiskimit.

Në Kapitullin e IV të quajtur Marrëveshjet dhe Barrierat Tregtare mes Kosovës dhe Shqipërisë kandidatja ka përfshirë këta nënkapituj: 1. Marrëveshjet dhe Barrierat Tregtare mes Kosovës dhe Shqipërisë 2. Tregtia dhe Potencialet e pashfrytëzuara 3. Pengesat e identifikuarra 4. Zbatimi i Marrëveshjeve 5. Biznes Vëllazëror mes 8 Barrierat tregtare mes Kosovës dhe Shqipërisë 6. Kërkesat për noterizim të analizës fitosanitare 7. Kosto për skanerin në doganë 8. Çmimet referencë 9 Kosto per tarifë rrugore 10. Korrupsioni nga oficerët doganor 11. Mungesa e Besimit në Partner Biznesor 12. Akciza diskriminuese në sasi të Alkoolit

Në Kapitullin e V të quajtur Ligjet e Aplikueshme në Republikën e Kosovës kandidatja ka përfshirë kë nënkapituj: 1. Ligji Doganor dhe i Akcizave në Kosovë 2. Ligji për Investimet e Huaja 3. Intervista e zhvilluar me depon e barnave Santefarm SH.P.K

Në bazë të analizës dhe vlerësimit të punimit të Diplomës për Mastër të kandidatës Bubulina Cakolli del se ajo i ka përmbushur kriteret e një punimi kërkimor të pavarur. Kandidatja ka arritur që duke aplikuar metodologjinë kërkimore dhe duke u bazuar në literaturën dhe burimet bibliografike përkatëse të hartojë një punim që tregon ambicien e saj që të merret me punë kërkimore. Prandaj, si Komision vlerësojmë se punimi mund të mbrohet në mënyrë publike meqë i plotëson të gjitha kushtet e një punimi të Diplomës për Studime Master

Fjalët kyçe: Tregtia e Jashtme e Kosovës, Barrierat Doganore, Ligjet e Aplikueshme në Kosovë, Kosova në CEFTA